

VENDIM
Nr. 635, datë 27.10.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 220 kV, KOMSI-SHUMBAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 220 kV, Koms –Shumbat”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 310 490 (treqind e dhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 310 490 (treqind e dhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
 5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
 8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, e të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 220 kV KOMSI - SHUMAT

Nr. i shtyllës	Pronësia										
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e pronës m²	Sip. e pronës që shpronësohet m²	Çmimi i shpronësimit në lek/m²	Vlera totale e shpronësimit	Shënime
KOMSI MUZHAKË											
2	Mendim	Sel	Mema	2213	238/11	Arë + Truall	500	78.8	114	8983	
78.8											
3	Ramiz	Riza	Metra	1705	230/20	Arë	2600	105.7	114	12050	
MIDHE											
6	Zanun	Shaqir	Sula	2688	133/15	Arë	2800	101.7	114	11594	
BATER E VOGEL											
11	Shaban	Arif	Kadiu	1126	67/4	Arë	2700	112.1	114	12779	
12	Ahmet	Hysen	Lika	1126	59/1	Arë	1250	134.5	114	15333	
KURDARI (KLOS)											
21	Xhemal	Ali	Troci	2334	810	Arë	4300	123.0	114	14022	
22	Ahmet	Tafe	Ballabani	2334	816	Arë	13500	95.6	114	10898	
23	Dyleman	Kros	Tuna	2334	819	Arë	8500	134.5	114	15333	
24	Jonuz	Rustem	Mellani	2334	127/2/2	Arë	3000	134.5	114	15333	
25	Barush	Mersin	Hystuna	2334	126/3/2	Arë	6700	91.8	114	10465	
KURQELAJ (KLOS)											
33	Dave	Sali	Shahini	1719	88	Arë	5800	118.6	114	13520	
VINJOLL											
38	Alban	Ndue	Filaj	3779	516/7	Arë	9128	91.8	114	10465	
41	Sali	Ali	Suluka	3779	493	Truall	300	114.3	145	16574	
Murrë - Peshkopi											
63	Hasan		Miha	2744	257	Arë	4160	123.0	115	14145	
65	Tahir		Biba	2744	191	Arë	2880	66.5	115	7648	
	Shaban		Prejsi	2744	192	Arë	1012	31.2	115	3588	
66	Jonuz		Miha	2744	164	Arë	1076	112.1	115	12892	
Selishtë e Epërme - Peshkopi											
77	Sinan		Fera	3291	406	Arë	3030	134.5	115	15468	
78	Aqif		Bodini	3291	213	Pemëtore	14187	82.4	115	9476	
79	Aqif		Bodini	3291	213	Pemëtore	14187	78.8	115	9062	
Fushë Muhurr - Peshkopi											
106	Laim		Voka	1668	570/26	Arë	1125	88.0	115	10120	
107	Selman		Xhani	1668	405/12	Arë	1812	112.1	115	12892	
109	Dine		Sina	1668	313/1	Arë	1000	97.5	115	11213	
	Kapllan		Sina	1668	313/2	Arë	1000	2.1	115	242	
Bllicë - Peshkopi											
125	Abdulla		Bitri	1226	116/67	Arë	3000	101.7	115	11696	
126	Bafjar		Tota	1226	51/14	Arë	4620	91.8	115	10557	
127	Zabit		Nezha	1226	48/76	Arë	5500	123.0	115	14145	
Sipërfaqja totale e shpronësimit m²								2681.6			

Vlera totale e shpronësimit në lek për sipërfaqet e pronësisë	310490
---	--------